

BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Golden Eagle Ylli, kampion i Kosovës

Golden Eagle Ylli e ka mundur Trepçën me rezultat 64:70 (18:22, 17:16, 16:13, 13:19), duke u shpallur kampion i Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll, pasi në serinë finale triumfoi 3:1. Ylli ishte lider i garave në rregullta, ndërsa në gjysmëfinale kishte eliminuar Sigal Prishtinën. Kështu Ylli u shpall kampion për herë të dytë radhazi. Mikaile Tmusiq u zgjodh MVP i "Play-off"-it, trofe të cilin ia dorëzoi kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, i cili së bashku me Ministrin e Sportit, Hajrulla Çekun dorëzuan trofeun e Kupës te kapiteni i Yllit, Gëzim Morina.



Penza, kampione e Kosovës

Penza e ka mundur Prishtinën me rezultat 79:62 (21:18, 14:19, 25:5, 19:20), në ndeshjen e katërt finale të "Play-off"-it të Superligës së Femrave, duke u shpallur kampione e Kosovës dhe mbrojti titullin e fituar edicionin e kaluar. Vashat pejane fituan 3:1 në serinë finale dhe u stolisën me titullin e kampionit. Medaljet e argjendta i kanë ndarë anëtarët e Bordit të FBK-së, Teuta Abdullahu dhe Dardan Kasapolli, kurse medaljet e arta i kanë ndarë Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku. Kupën kapitenes së Penzës, Valbona Bytyqi ia dorëzoi kryetari i FBK-së, Arben Fetahu.



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Festë në Pejë, shpallet kampion i Ligës Unike

Peja ka mundur Golden Eagle Yllin me rezultat 72:87 (19:23, 15:26, 19:20, 19:18), për tu shpallur për herë të parë kampion i Ligës Unike. Në një spektakël të madh të basketbollit, pikërisht në Pejë, verdhezinjtë arritën trofeun e parë për këtë edicion, duke mundur Ylli, që edicionin e kaluar kishte fituar këtë garë. Spektakli u zhvillua në Pejë. Verdhezinjtë në gjysmëfinale kishin mundur Prizrenin 16, ndërsa therandasit kishin eliminuar Teutën e Durrësit. Vendi i tretë u takoi prizrenasve. MVP është shpallur Dardan Berisha, çmim të cilin ia ndau Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe Sekretari i Përgjithshëm i FBSH-së, Korab Llazani. Ndërkohë, trofeun e kupës, Berishës, ia kanë dorëzuar kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe kryetari i Bordit Drejtues të Ligës Unike, Ilir Trebicka.



“Ekipa e Zezë” dhe “Deja Vu” fitojnë në turneun selektiv në 3x3

Më 7 maj është zhvilluar turneu selektiv në 3x3, i organizuar nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Te meshkujt, 11 ekipe janë ndarë në katër grupe, me nga tri skuadra, një me dy, kurse më pas janë zhvilluar ndeshjet çerekfinale, gjysmëfinale dhe finalja e madhe. Ndeshjet në Margjona Rezidencë kanë qenë interesante, me aksione të bukura, ndërsa është ndjekur nga një numër i kënaqshëm i tifozëve, që kanë pasur mundësi të shohin sfida interesante në 3x3. Pas shumë përballjeve interesante, është zhvilluar finalja e madhe mes “Ekipa e Zezë” dhe Grapleand, ku “Ekipi i Zezë” shënoi fitore 15:11. Te femrat është zhvilluar finalja ndërmjet “Deja Vu” dhe “Masterpices”, ku ekipi i “Deja Vu” kanë shënuar fitore me rezultat 19:12.



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Vëllaznimi te Meshkujt dhe United Basketball te Femrat nga edicioni i ardhshëm në Superligë



Kampionët e Gjeneratave të reja

Megasport, kampion i Kosovës për U12

Marigona Hill Prishtina triumfon në Lindje U14

Peja DT, kampion në Perëndim U14

Marigona Hill Prishtina triumfon në Lindje U14 dhe shpallet kampion i Kosovës

New Basket, kampion i Ligës U16

Marigona Hill Prishtina, kampion i Kosovës për U16

Junior 06, kampion i Kosovës për U16 te vajzat

Golden Eagle Ylli, kampion i Ligës me U18 (M)

Marigona Hill Prishtina, kampion i Superligës U18



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Mbahet Seminari i Dytë për klubet e FBK-së

Më 6-7-8 Maj është mbajtur Seminari i Dytë për Klubet, i organizuar nga Federata e Basketbollit e Kosovës, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga klubet e Kosovës. Seminari ishte treditor, ndërsa qëllimi ishte zhvillimi dhe fuqizimi i klubeve të basketbollit.

Dita e parë:

Ligjëruan ekspertët nga FIBA, Pedro Correia dhe Florian Pasquet me temat Licencimi i Klubeve dhe Qeverisja dhe Menaxhimi Financiar i Ligës.

Dita e Dytë:

Ligjëruan Pedro Correia dhe Florian Pasquet me temat: Qeverisja dhe Menaxhimi Financiar i Klubeve dhe Rrugëtimi i Lojtarëve.

Dita e Tretë:

Ka ligjëruar Geoff Wilson me temën: Planifikimi Operacional dhe Hapat e Ardhshëm.



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

JUNIOR NBA

Indiana Peacers (Hasan Prishtina-Prishtinë), kampion i parë i JR NBA i Kosovës

Më 21 maj në palestrën "Don Bosko" është mbajtur Final 4 i JR NBA Kosovës, ku janë zhvilluar ndeshjet gjysmëfinale dhe finalja e madhe. Ky ishte edicioni i parë dhe historik i kësaj gare, që u organizua nga Federata e Basketbollit e Kosovës, një projekt madhor për zhvillimin e talentëve të basketbollit dhe duke ju bashkuar shumë shteteve që e kanë këtë ligë. Në fillim ishin 30 Shkolla Fillore të moshës 11-13 vjeç, djem dhe vajza në një ekip, ku janë ndarë në dy Konferenca, Lindore dhe Perëndimore, apo gjashtë Divizione. Më pas tetë më të mirat e secilës konferencë luajtën në çerekfinale e gjysmëfinale, për të dhuruar katër skuadrat më të mira.

Në gjysmëfinalen e parë, Indiana Peacers (Hasan Prishtina-Prishtinë) e ka mundur Atlanta Hawks (SHMU 2 Vushtrri) me rezultat 46:25. Lojë më e barabartë dhe interesante u zhvillua gjysmëfinalja e dytë, ku Golden State Ęarriors (Emin Duraku-Prizren) shënoi fitore kundër San Antonio Spurs (Emin Duraku-Kaçanik) me rezultat 32:29. Në finale Indiana Peacers ka shënuar fitore ndaj Golden State 53:34, ku pothuajse gjatë gjithë kohës ishte duke udhëhequr. Skuadrat humbëse të gjysmëfinaleve janë stolitur me medaljet e bronza, vendit të dytë i kanë takuar medaljet e argjendta, kurse vendit të parë, unazat e kampionit.



Kosova për herë të parë pjesëmarrëse në kampionat elitare të Evropës dhe Lindjes së Mesme të JR NBA

Kosova për herë ishte pjesëmarrëse në kampionat elitare të Evropës dhe Lindjes së Mesme. Përfaqësues nga Kosova ishin Arben Krasniqi, në cilësinë e trajnerit, basketbollistja Malvina Haziri dhe basketbollisti Yll Kastrati. Kampi u zhvillua nga 4 deri më 7 Maj në Stella Azzurra në Romë. Ky kamp përfshin 60 djem dhe vajza të moshave 13-14 vjeç nga 25 vende nga Evropa dhe Lindja e Mesme, ku aktualisht funksionojnë programet e NBA Jr.



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Turneu i YDF-së

Kosovë

Në Kosovë, përkatësisht Therandë, nga 9 deri më 12 Prill është organizuar turneu i YDF-së për grupmoshat U14 te meshkujt dhe femrat. Vashat fituan ndaj Maqedonisë Veriore dhe Turqisë, duke pësuar nga Rumania dhe Bullgaria, kurse djemtë pësuan vetëm nga Bullgaria, duke mundur Rumaninë, Maqedoninë Veriore dhe Turqinë.

Bullgari

Në turneun e YDF-së në Bullgari, vashat e Kosovës shënuan një fitore (ndaj Maqedonisë Veriore), ndërsa pësuan nga Turqia, Bullgaria dhe Rumania. Kosova te meshkujt e përfundoi turneun me tri humbje e një fitore, ku mundi Maqedoninë Veriore, ndërsa pësoi nga Bullgaria, Rumania dhe Turqia.

Rumani

Te femrat, Kosova mundi Turqinë dhe Maqedoninë Veriore, ndërsa kanë pësuar nga Rumania dhe Bullgaria. Edhe meshkujt e përfunduan turneun me dy fitore e dy humbje. Fituan ndaj Turqisë dhe Bullgarisë, ndërsa pësuan nga Maqedonia Veriore dhe Rumania.

Turqi

Kosova këtë turne e mbyll me dy fitore në konkurrencën e meshkujve dhe dy humbje, kurse femrat kanë arritur vetëm një fitore, atë ndaj Maqedonisë Veriore dhe tri humbje.



FIBA

We Are Basketball

**FIBA EUROPE
YOUTH DEVELOPMENT FUND**



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Djemtë dhe vashat dardane regjistrojnë nga një fitore në FIBA Europe Cup në 3x3

Kosova më 4-5 qershor ka zhvilluar ndeshjet në kuadër të parakualifikimeve për FIBA Europe Cup në 3x3.

Rezultatet:


Kosova-Shqipëria (M)	13:10
Irlanda-Kosova (M)	21:13
Kosova-Luksemburgu (M)	10:19
Kosova-Irlanda (F)	13:16
Andorra-Kosova (F)	9:12
Kosova-Malta (F)	12:14



Katër vjet pa Gazmend Sinanin

Më 23 qershor janë bërë katër vjet nga vdekja e ish-basketbollistit të njohur, Gazmend Sinani, i cili kishte humbur jetën në një aksident trafiku. Gazi ishte shembull se si luftohet për fanellën e skuadrës dhe të Përfaqësueses së Kosovës. Krahas një shpirti luftarak në parket Gazi ishte i dashur nga tifozët dhe bashkëlojtarët. Sinani mbetet shembull për të gjithë. Ai ishte anëtar i Kombëtares së Kosovës, që nga pranimitë e FBK-së në FIBA, ndërsa fanella me numër 15 është pensionuar përgjithmonë nga Federata e Basketbollit të Kosovës.

Kosova përveç që humbi një basketbollist të shkëlqyer, humbi edhe një djalë të jashtëzakonshëm. Kujtimi për Gazin do të mbetet përgjithmonë.



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Përfaqësueset e Kosovës

Në qershor janë grumbulluar:

Kosova A e femrave

Kosova A e meshkujve

U20 te meshkujt

U20 te femrat

U18 te meshkujt

U16 te meshkujt

Në korrik dhe gusht do të garojnë:

Kosova A femrat deri më 2 Korrik në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro

Kosova U20 (F) në Divizionin B, ku do të sfidojnë Kroacinë, Rumaninë, Malin e Zi dhe Maqedoninë Veriore. Kampionati zhvillohet në Shkup nga 9 deri më 17 Korrik në Shkup.

Kosova U16 e meshkujve do të jetë në grup me Shqipërinë, San Marinon dhe Maltën, kurse në Grupin tjetër janë Andorra, Gjibraltari, Moldavia dhe Armenia. Kampionati zhvillohet në Prizren 12 deri më 17 Korrik.

Kosova U18 te meshkujt do të jetë në grup me Holandën, Bosnja e Hercegovinën, Bullgarinë, Gjeorgjinë dhe Norvegjinë. Garat mbahen në Oradea të Rumanisë nga 29 Korriku deri më 7 Gusht.

Kosova U20 te meshkujt është në grup me Suedinë, Gjeorgjinë, Maqedoninë Veriore dhe Austrinë. Kampionati mbahet në Tbilisi të Gjeorgjisë nga 15 deri më 24 Korrik.



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Kosova pëson nga Danimarka

Kosova ka pësuar humbje nga Danimarka me rezultat 105:71 (26:19, 20:17, 30:17, 29:18), në ndeshjen e Grupit C të rrethit të parë parakualifikues për FIBA Eurobasket 2025. Te Kosova u dalluan Dardan Berisha dhe Drilon Hajrizi me nga 17 pikë. Kosova përfundon grupin me një fitore dhe tri humbje, ndërsa Danimarka dhe Norvegjia kanë nga dy fitore e një humbje.



Kosova me një fitore e dy humbje në Evropian

Në Evropianin për Shtetet e Vogla që zhvillohet në Qipro, në muajin qershor, Kosova regjistroi një fitore e dy humbje. Vashat e Kosovës fituan ndaj Andorrës dhe pësuan nga Malta e Qipro.

Kosova-Malta 61:68

Andorra-Kosova 56:77

Kosova-Qipro 67:88



BULETINI INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2022

Aktivite të ndryshme të FBK-së

FIBA lavdëron punën që FBK po e bën për Fuqizimin e Klubeve

MKRS përkrah projektet e FBK-së

Adriatik Rraci emërohet Menaxher i Përfaqësueseve të Kosovës

Zbulohet Logo e Evropianit

FBK nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Sportradar

Her World, Her Rules në Prizren

FBK me Komision të Veteranëve

Kosova mysafire e Federatës së Basketbollit të Turqisë

Premtohet spektakël në FIBA 3x3 Challenger Prishtina

Konfirmohet kampioni i Kosovës në raundin kualifikues të Basketball Champions League


Erjon Kastrati, Ambasador i FBK-së në programin FIBA SWISH +

FBK nderon vëzhguesit Ergin Sherifi dhe Nexhdet Hoxha

Arben Krasniqi dhe Artina Hasani, pjesë e Konventës së Minibasketbollit në Hungari

FBK dhe Policia e Kosovës shënojnë 1 Qershorin, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve

FBK i bashkohet kampanjës në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe



BULETINI INFORMATIV
PRILL - QERSHOR 2022

FALEMINDERIT

